



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 05, datë 22.01.2024**

**MBI  
RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “SANG 1” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË  
E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “d”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “e”, 5, pika 1, gërma “e”, 13 dhe 16 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin, dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 22.01.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 51/2 prot., datë 15.01.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “SANG 1” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”.

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “SANG 1” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2435/1 prot., datë 20.12.2023, ka paraqitur kërkesën për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 380, datë 28.12.2023 vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “SANG 1” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 106, datë 26.06.2019.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 30.12.2023 dhe 04.01.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 08.01.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Ky njoftim u publikua dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresën nr. 51 prot., datë 08.01.2024, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës si dhe njoftimin për të plotësuar dokumentacionin e konsideruar të plotësuar pjesërisht në lidhje me këtë aplikim.
- Në vijim, shoqëria me shkresën me nr. 51/1 prot., datë 11.01.2024 ka përcjellë tërësisht dokumentacion e kërkuar.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit në zbatim të përcaktimeve të Aneksit A të rreullores si dhe ka shlyer ndaj ERE-s të gjitha detyrimet për sa i përket pagesave të rregullimit.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të rinovojë licencën e shoqërisë “SANG 1” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 106, datë 26.06.2019, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 27.06.2024.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**